



Breaking News:

Tiranë/Policia Rugore, kontrolle intensive në të gjitha akset rrugore të kryeqytetit

|| << >>



Lajmet

Operacionet

21/09/2025

Tiranë/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Kombinimi”

Tiranë/Vijojnë operacionet e njëpasnjëshme për goditjen e armëmbajtjes pa leje dhe të shpërndarjes së lëndëve narkotike.

Finalizohet nga Komisariati i Policisë Nr. 2, operacioni policor i koduar “Kombinimi”.

Shpërndante lëndë narkotike kokainë dhe mbante armë zjarri dhe municion luftarak në banesë, vihet në pranga 35-vjeçari.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë, rreth 135 gramë kokaine, të cilën dyshohet se e posedonte me qëllim shitjen në doza dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2 në vijim të punës për goditjen e aktivitetit kriminal të shpërndarjes së lëndëve narkotike dhe armëmbajtjes pa leje, pas një informacioni të siguruar në rrugë operative, organizuan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar “Kombinimi”, në kuadër të të cilit vunë në pranga shtetasin: -M. P., 35 vjeç, banues në Tiranë. Gjatë kontrollit të banesës së tij shërbimet e Policisë gjetën një armë zjarri pistoletë të cilën e kishte fshehur te depozita e ujit, municion luftarak dhe lëndë narkotike kokainë.

Nga veprimet hetimore të kryera dyshohet se pasi siguronte lëndë narkotike kokainë, e ndante në doza me qëllim shitjen e saj.

Gjithashtu, gjatë veprimeve procedurale, rezultoi se ky shtetas gjatë një konflikti për motive të dobëta, kishte goditur me qytën e pistoletës, shtetasin S. I, duke i shkaktuar dëmtime sipërfaqësore.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON

Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

< [Korçë/Shiste kokainë e kanabis, kapet dhe vihet në pranga 34-vjeçari](#)

[Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Metoda”](#) >